



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 04
Prishtinë, më 13.03.2013, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302.

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novobërdali, Rita Hajzeraj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kimete Bytyçi, Kymete Bajraktari, Duda Balje dhe Albana Gashi.

Mungoi: Justina Pula.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, Sulltane Gashi - zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Të ftuar: Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Ramë Buja -këshilltarja Selvije Halimi dhe Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Nenad Rashiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Florije Kryeziu-UNICEF; Basri Berisha-IAP, Merita Sylja-IAP, Bajram Kelmendi-MPMS, Minire Begaj-MPMS, Xhavit Dakaj-MASHT, Lulevera Behluli-MASHT, Afrim Maliqi-Handikos, Laura Pollozhani-ECMI Kosova, Visar Bivolaku-EUO/EUSK, Osman Shatri-HANDIKOS, Ervin Ibrahim-UNDP/PDSP, Xhavit Nura-Koha Ditore, Erxhan Gashi- praktikant, OSBE-ODIHR.

Mbledhjen e kryesoi Suzan Novobërdali, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19 shkurt 2013;

3. Shqyrtimi i raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2011 rreth zbatimit të rekomandimeve që lidhen me ministrinë;
4. Marrja e qëndrimit rreth procedimit të mëtejshëm lidhur me udhëzuesin për shqyrtimin e peticioneve;
5. Njoftim lidhur me ankesën e Slobodan Petroviqit kundër Komunës së Prishtinës, e vendosur nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit;
6. Të ndryshme.

Kryetarja – Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja- Propozoj që të fillohet me pikën e tretë të rendit të ditës për të mos u marr shumë kohë përfaqësuesve të ministrive të cilit janë ftuar në mbledhje.

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

3. Shqyrtimi i raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2011 rreth zbatimit të rekomandimeve që lidhen me ministrinë

Kryetarja- Falënderoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Nenad Rashiq dhe këshilltaren e Ministrisë të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Selvije Halimi, të cilët i janë përgjigjur ftesës së Komisionit për pjesëmarrje në mbledhje.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, ka disa rekomandime të raportit të Avokatit të Popullit, ku janë konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut, dhe në disa raste shkelje të drejtave të fëmijëve. Ne jemi të interesuar të informohemi se çka është ndërmarrë nga institucionet tuaja, për respektimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në raportin vjetor të vitit 2011.

Ne kemi vërejtur disa ligje, të cilat janë diskriminuese, si Ligji për ndihmën sociale, ligjin që ka të bëjë me personat me aftësi të kufizuara, ligjin për pensionet, ligjin për aftësim riaftësim profesional të personave me aftësi të kufizuara, për këto do të informohemi nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale se çka është duke u ndërmarrë nga kjo ministri për përmirësimin e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara.

Nenad Rashiq- Falënderoi anëtarët e Komisionit për ftesën dhe pyetjet e bëra atij dhe tha se jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë, e sidomos për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara dhe se kemi një situatë mjaft komplekse. Fondet tona janë të kufizuara, krahas saj është edhe një pengesë që ekziston niveli i ultë i përgjegjësisë së institucioneve. Dhe nuk them se jemi më të mirët, po sa i përket çështjeve teknike ministria e jonë i ka bërë të gjitha punët.

Presim të miratohen disa akte nënligjore, personat me aftësi të kufizuara nuk kanë të bëjnë vetëm me ministrinë tonë, por edhe me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe kabinetin e Kryeministrit. Ne që dy vite insistojmë në formimin e një

kodi të veçantë në Ministrinë e Financave, i cili do të bënte që komunat me mjetet të cilat u ndahen për shërbime sociale të jenë të destinuara për shërbime sociale dhe jo për shërbime të tjera. Mirëpo Ministria e Financave ka dalë me një arsyetim zyrtar se kërkesa për një kod të tillë nuk është në përputhje me ligjin.

Minire Begaj-MPMS- Tha se në momentin që ka hyrë në fuqi ligji për aftësim e riaftësim profesional të personave me aftësi të kufizuara, ministria si organ ka nxjerrë aktet administrative të cilat e bëjnë të zbatueshëm këtë ligj.

Ministria ka arritur t'i standardizojë të gjitha hapësirat e arsimit në qendrat e aftësimit profesional duke llogaritur në qasjet e tyre. Në këtë vit do të bëhet edhe ndryshim-plotësimi i ligjit për aftësim dhe riaftësim profesional të personave me aftësi të kufizuara dhe do të shmangen mangësitë ekzistuese.

Kryetarja- Bëri pyetje se a ka kjo ministri të dhëna sa familje kanë persona me aftësi të kufizuara dhe sa janë të përkushtuara institucionet për këta persona.

Bajram Kelmendi, MPMS- Tha se do të ndalet në ligjin për përkrahjen e familjeve që kanë fëmijë me aftësi të përhershme të kufizuara, pas këtij ligji kemi nxjerrë edhe një udhëzim administrativ, ku kemi paraparë të gjitha specifikat e familjeve që kanë fëmijë me aftësi të përhershme të kufizuara.

Aktualisht këtë të drejtë e fitojnë 3030 fëmijë, prej tyre 1777 janë meshkuj dhe 1253 janë femra. Shërbimet sociale u ofrohen të gjithë qytetareve që gjenden në territorin e Kosovës.

Këtyre fëmijëve e drejta për ndihmë sociale u rregullohet me ligj dhe udhëzim administrativ. Ky ligj ju njeh të drejtën fëmijëve që kanë nevoja qind për qind me aftësi të kufizuara; është një kategori e fëmijëve të cilët kërkojnë përkujdesje 24 orë. Kjo e drejtë për këta fëmijë dhe këta familjarë nuk jepet duke u bazuar nga pozita e tyre materiale, por nga gjendja e tyre shëndetësore.

Se kush do të fitoj nga ky ligj vlerësimin e bënë komisioni mjekësor. Ky ligj nuk rregullon të gjitha të drejtat që duhen t'i kenë këta fëmijë, të drejtat e fëmijëve me këto aftësi të kufizuara nuk janë çështje e një ministrie, është çështje e shumë ministrive. Ne me këtë ligj kemi rregullua vetëm përkrahjen materiale, dhe ky ligj u dedikohet vetëm fëmijëve prej 1-18 vjeç, 721 fëmijë që kanë arritur moshën madhore u është ndërprerë kjo skemë dhe duhet të aplikojnë për një skemë tjetër sociale, e cila rregullohet me ligj tjetër, sepse kemi një program që fëmija si të arrij moshën madhore vetë programi e largon nga pagesa.

Rita Hajzeraj- Tha se disa fëmijë lindin me aftësi të kufizuara, ndërsa disa e fitojnë këtë gjatë jetës së tyre. Ajo pyeti se qysh identifikohen këta fëmijë, a vijnë prindërit dhe i lajmërojnë, apo ndërmerr ministria ndonjë aktivitet nëpër komuna për të bërë një regjistrim të këtyre fëmijëve? Ose nëpër qendra të lindjes nëpër tërë Kosovën, sepse kemi informata që prindërit nuk janë në dijeni se kanë mundësi ta gëzojnë këtë të drejtë dhe vazhdojnë trajtimin me mjete të tyre vetanake.

Bajram Kelmendi- Duke u ndërlidhur me pyetjen e anëtares së Komisionit, tha se kur e kemi aprovuar këtë skemë 6 muaj është bërë propagandimi i saj, janë bërë takime nëpër

të gjitha regjionet e Kosovës, ka pasur shpallje publike, informimi ka qenë në nivelin e duhur, pra kërkesat bëhen nga familjarët.

Kryetarja- Pyeti se a janë nxjerrë të gjitha aktet nënligjore, sa u përket këtyre ligjeve, sepse jam në dijeni se nuk janë nxjerrë të gjitha aktet nënligjore, sa i përket ligjit për pensionet e personave me aftësi të kufizuara.

Minire Begaj- Tha se sa i përket ligjit për pensionet e personave me aftësi të kufizuara, në momentin që ka hyrë ligji në fuqi, ministria i ka nxjerrë të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Mirëpo problemi i moszbatimit të nenit 13.7, që ka mbetur i pazbatueshëm, nuk është pjese vetëm e ministrisë sonë, sepse ky nen i parasheh tri-katër ministri që janë përgjegjëse për ta zbatuar këtë nen.

Sa i përket ligjit për aftësim dhe riaftësim është e paraparë se nëse punëdhënësi nuk punëson një person me aftësi të kufizuara në 50 punëtorë, ajo ndërmarrje duhet të paguajë 70% të pagës minimale me qëllim që këto mjete të arrijnë ta avancojmë arsimin, punësimin dhe çfarëdo nevojë që kanë.

Duda Balje- Tha se ministri pak më parë foli për projektin prej 1 milion euro. Ajo pyeti a do të jenë ato projekte të decentralizuara dhe kush mund të aplikojë? Kush vendos për këto mjete për formimin e inkubatorit social dhe si do të ndahen këto mjete?

Nenad Rashiq- Tha se sa i përket projektit për inkubatorin social tani më është vendosur mënyra, do të jenë dy inkubatorë sociale provuese njëri në Graçanicë e tjetri në Prizren. Është një ide e parë e këtij lloji dhe nëse tregohet i suksesshëm në këto dy komuna, do vazhdojmë me inkubatorë regjional social dhe qëllimi i fundit është që secila komunë të ketë një inkubator social.

Projekti i dytë është për rehabilitimin e punësimit, edhe vlera e këtij projekti është një milion euro, ky projekt do të jetë në dhjetë qendra, kjo është për fillim që të implementohet pjesa e parë e projektit.

Biserka Kostiq- Tha se për disa pyetje që donte t'i bënte u dhanë përgjigjet, ajo pyeti se çka do të bëhet me ato institucione që nuk respektojnë ligjin që rregullon punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Kryetarja- Tha se kemi një informacion meqë kemi prezent edhe Ministrinë e Arsimit që janë deri dhjetëmijë persona që kanë nevojë për përfitim, pse ka dallime në numra sa i përket ligjit për pensionet, nëse personi gjen punë ky pension edhe pse nuk duhet të quhet kështu, u ndalet, sepse ndodh që ajo punë gjendet përkohësisht dhe prapë duhet të ndjekin formalitetet për të aplikuar për atë ndihmë.

Bajram Kelmendi- Tha se ky dallim në numra është, sepse pjesa më e madhe e këtyre personave nuk mundën të shkojnë në shkollë, sepse kanë nevojë për përkujdesje 24 orë në ditë, dhe këta persona nuk ekzistojnë fare në evidencën e Ministrisë së Arsimit, sepse në evidencën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale janë personat me aftësi të kufizuara qind për qind, jo edhe ata që shkojnë në shkollë.

Albana Gashi- Bëri pyetje për fëmijët të cilët nuk vijojnë shkollimin, çka është ndërmarrë për këto raste, a ka ndonjë plan konkret për trajtimin e tyre?

Bajram Kelmendi- Tha se nuk vijon mësimin për arsye shëndetësore, ka persona që nuk kanë aftësi komunikimi, dëgjimi dhe nuk mundën me mbajt as higjienën personale, etj.

Kimete Bytyçi- Tha se u përmend se 20 për qind të kësaj kategorie të personave me aftësi të kufizuara mbajnë, kurse dhe 10 për qind prej tyre do të punësohen. Ajo pyeti sa janë të punësuar tani, a ka evidencë të të punësuarve për këtë kategori personash.

Nenad Rashiq- Tha se kemi një evidencë, por asnjëherë nuk kemi numra të saktë për të gjitha institucionet, ka të punësuar edhe në sektorin privat.

Rita Hajzeraj- Tha se sa i përket shumës që duhet paguar punëdhënësi është një shumë minimale dhe kjo shumë duhet të rritet. Ajo e pyeti ministrin Rashiq se a është shtuar numri i inspektorëve në inspektoratin e punës?

Nenad Rashiq- Tha se është rritur numri i inspektoreve për pesë veta gjatë vitit të kaluar.

Albana Gashi- Tha se me ligj është e paraparë që në çdo 50 të punësuar të jetë i punësuar edhe një person me aftësi të kufizuara, meqë janë prezent edhe përfaqësuesit e Handikosit, a është ky numër i mjaftueshëm apo duhet të ndryshohet ky numër?

Kimete Bytyçi- Tha se i intereson të dijë numrin e saktë të punësuarve me aftësi të kufizuara.

Minire Begaj- Tha se ka evidencë sa i përket Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku janë të punësuar gjashtë persona me aftësi të kufizuara.

Kryetarja- Falënderoj Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe zyrtarët e kësaj ministrie për raportimin para Komisionit.

Ajo tha se do të vazhdojmë me rekomandimet që kanë të bëjnë me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Janë disa pyetje që rrjedhin nga rekomandimet e institucionit të Avokatit të popullit për nxënësit me nevoja të veçanta, për përmirësimin e cilësive të objekteve shkollore, sidomos në zonat urbane të cilat janë të mbipoplluara, të luftohet braktisja e shkollimit, dhuna nëpër shkolla, a ka propagandë fetare nëpër shkolla, çfarë lehtësira ka nëpër universitete për studentet me aftësi të kufizuara dhe qasja e personave me aftësi të kufizuara nëpër shkolla.

Selvie Halimi, këshilltare në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë- Tha se ka pranuar pyetje nga Komisioni të cilat lidhen kryesisht me personat me aftësi të kufizuara, por do të bëjë përpjekje të përgjigjet edhe në pyetje tjera, për aq sa ka informacione, apo do të dërgojë përgjigjeje me shkrim.

Ajo tha se numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara për moshën e arsimit të obliguar është 5993 fëmijë, të gjithë janë të përfshirë në arsimin e obliguar, në qendra burimore janë 454 nxënës me aftësi të kufizuara, në klasa të bashkëngjitura janë 668 nxënës dhe në klasa të rregullta janë të përfshirë 222 nxënës.

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që nuk është i përfshirë në sistemin e arsimit nuk është i saktë.

Qasje për fëmijët me aftësi të kufizuara kanë 505 objekte shkollore, gjithashtu kanë edhe disa fakultete pjerrinat për karroca, po ashtu edhe konvikti numër 6 dhe 7 është ndërtuar infrastrukturë për qasje të studentëve me aftësi të kufizuara, fëmijët kanë qasje në transportin publik, ku për 999 nxënës transporti paguhet nga Ministria e Arsimit, kurse të tjerëve nga komuna përkatëse. Në universitete publike është një kuotë e cila u dedikohet personave me aftësi të kufizuara, të cilët dëshirojnë të vijojnë studimet, ju sigurohet, jo në tërësi materiali dhe literatura për të verbrit, shkrimi përmes brajllit, sigurimi i interpretuesve të gjuhës së shenjave për personat e shurdhër, dhe lirimi nga pagesat i kësaj kategorie për regjistrimin në fakultet. Kemi bashkëpunim me të gjitha komunitete, kemi pak ngecje sa i përket komunitetit RAE.

Sa i përket braktisjes së shkollave në arsimin fillor është 0.6%, ndërsa në arsimin e mesëm është 2%, jemi duke punuar në drejtim të ndalimit të braktisjes së shkollave.

Për mbrojtjen e nxënësve nga propaganda fetare kemi pasur një takim me kryetarin e bashkësisë islame të Kosovës që të kemi një elaborim më të drejtë në përputhje me Kushtetutën.

Rita Hajzeraj- Sa shkolla plotësojnë kushtet për nxënësit me aftësi të kufizuara, a kanë tekste, a kanë materiale, a janë të përfshirë sikurse nxënësit e tjerë në të njëjta klasa për shkak të socializmit.

Ajo ngriti edhe çështjen e peshës së librave, sepse nxënësit prej klasës së parë deri në klasën e njëmbëdhjetë kanë shumë libra, çantat e tyre kanë një peshë të rëndë në krahasim me moshën e tyre, prindërit e tyre janë të obliguar t'ju blenë çantat me rrota që fëmijët ta kenë me lehtë bartjen e librave. A ka menduar ministria e Arsimit lidhur me këtë të bëjë ndonjë ndryshim për lehtësimin e nxënësve?

Albana Gashi- Tha se Ministria e Arsimit dhe Ministria e Drejtësisë kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi që personat e privuam nga liria t'i ndjekin mësimet nëpër shkolla publike, por kjo është për arsimin parauniversitar, a keni menduar të lidhni një memorandum të tillë edhe për arsimin e lartë?

Ajo tha se shumë fëmijë nga zonat rurale në pamundësi të qasjes në transport për të vijuar shkollën braktisin shkollat. Përgjegjëse për këtë janë drejtoritë komunale të arsimit, por këto drejtori ankohen se ministria nuk ndan buxhet edhe për transportin, çka do të ndërmerret për këtë problem? Çka ka ndërmarr ministria që të luftohet analfabetizmi dhe çka është ndërmarrë lidhur me çështjet që nxënësit janë të detyruar të ndjekin, kurse shtesë si pasojë e numrit të madh të nxënësve nëpër klasa dhe detyrohen nga mësimdhënësit që të ndjekin, kurse po te ata mësimdhënëës. Po ashtu tha se dhe studentët kushtëzohen që studenti të ketë librin e profesorit, përndryshe nuk mundën me ju nënshtruar provimit të ai profesor, a keni pranuar ju, si ministri, ankesa të tilla?

Kymete Bajraktari- Personat me aftësi të kufizuara a janë të përfshirë në arsimin parafillor?

Selviqe Halimi- Tha se sa i përket peshës së librave edhe ne, si ministri jemi të shqetësuar për këtë çështje. Jemi në pilot- projekt të kurikulit dhe është afër një vit që ka filluar pilot-projekti. Për këtë projekt dy vite nevojiten, si do te behet zgjidhja? Janë dy zgjidhje ose te bëjmë ndryshime në kutikula ose të bëjmë dollapët për librat së paku prej klasës parë deri në klasën e pestë.

Sa i përket memorandumit me Ministrin e Drejtësisë me nxënësit e privuar nga liria ndjekin shkollën në shkolla publike, edhe studentet e gëzojnë këtë të drejtë, me sa unë kam informacione, nuk është problem për Ministrin e Arsimit me bërë një memorandum bashkëpunimi, por është problemi i sigurisë, kategorizohen veprat se cila kategori ka të drejtë të dalë dhe të vijoj arsimimin.

Sigurimi i transportit për fëmijët me udhëzim administrativ, çdo vendbanim me i largët se 5 kilometra nga shkolla duhet të sigurohet transporti publik, shkollimi parauniversitar është kompetencë e komunës. Nuk mund të them se mos sigurimi i transportit ka shkaktua braktisjen e shkollës. Kjo mund të shkaktojë probleme në vonesa, në mungesa, por jo edhe braktisje. Për kurset shtesë kjo ka lindur nga kërkesat e prindërve fillimisht.

Lulevera Behluli- Tha se në arsimin parashkollor janë 109 fëmijë me aftësi të kufizuara, kjo është evidencë e vitit 2012.

Kimete Bytyçi- Ka ankesa sa i përket ngarkesës se klasave me fëmijë në arsimin parashkollor për një fëmijë nevojitet të jetë 2.5 metra katror. Kjo është e përcaktuar me udhëzim administrativ, a ka ndonjë strategji të zbutjes së kësaj situate ngase kanë vështirësi edhe edukatorët me numër të madh të fëmijëve?

Selviqe Halimi- Është fakt numër i madh i fëmijëve dhe jashtë standardit, por ne është dashur që udhëzimin t’ia përshtatim kërkesave, sepse ka kërkesa të mëdha për t’i vendosur fëmijët nëpër çerdhe.

Kryetarja-Falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit. Ajo tha se me pikat e tjera të rendit të ditës do të vazhdohet në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novobërdali